FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

SPIRAMICINE

Tableta – 750 000 UI
(Spiramicinë)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë është Spiramicine dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Spiramicine
3. Si ta merrni Spiramicine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Spiramicine
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË SPIRAMICINE DHE PËRSE PËRDORET

Spiramicina është një antibiotik makrolid që ka përdorime të ngjashme me eritromicinën. Makrolidët janë baza të dobëta; veprimtaria e tyre rritet në pH alkalin. Makrolidët depërtojnë në lëngun pleural, lëngun ascitik, eksudatet e veshit të mesëm dhe në sputum. Kur meningjet janë të inflamuara, ata mund të hyjnë në lëngun trunoshpinor. Makrolidët përdoren në infeksionet e rrugëve të frymëmarrjes, urogjenitale, të aparatit tretës dhe të lëkurës e indeve të buta, sidomos në rastet kur antibiotikët beta-laktamikë ose tetraciklinat janë të kundërindikuar.

Spiramicine indikohet në:
- mjekimin e infeksioneve otorinolaringologjike, bronkopulmonare, stomatologjike, gjenitale (veçanërisht prostatike), kockore dhe të lëkurës;
- profilaksinë e meningjitit nga meningokokët;
- rastet kur rifampicina është e kundërindikuar;
- toksoplazmozën e grave të moshuara.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Spiramicine për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Spiramicine.

2. PËRPARA SE TË MERRNI SPIRAMICINE

Mos merrni Spiramicine në qoftë se jeni alergjik nga spiramicina apo nga lëndët ndihmëse të Spiramicine.

Tregoni kujdes të veçantë me Spiramicine
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Spiramicine.
Meqenëse spiramicina kalon në qumështin e gjirit, këshillohet që nënat ta ndërpresin ushqyerjen me gji të fëmijëve të tyre ndërkohë që mjekohen me spiramicinë.

Marrja e barnave të tjera
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë, keni marrë së fundmi ose mund të merrni barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni duke u trajtuar me:
- acenokumarol, varfarinë dhe digoksinë sepse spiramicina dhe makrolidët në përgjithësi mund ta rrisin efektin e tyre;
- ciklosporinë, sepse ka të ngjarë që spiramicina dhe makrolidët e tjerë mund ta frenojnë metabolizmin e saj (rritje e përqëndrimit plazmatik të ciklosporinës);
- levodopa (e dhënë njëkohësisht me karbidopa), sepse spiramicina ul nivelet plazmatike të saj duke reduktuar efektin e saj terapeutik.

Marrja e Spiramicine me ushqim dhe pije
Përthithja e spiramicinës reduktohet nëse merret me ushqimin.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.
Meqenëse spiramicina kalon në qumështin e gjirit, këshillohet që nënat ta ndërpresin ushqyerjen me gji të fëmijëve të tyre ndërkohë që mjekohen me spiramicinë.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk dihet nëse Spiramicine mund të ndikojë në aftësinë për të drejtuar automjetin dhe për të përdorur makineri.

Informacion i rëndësishëm për disa nga lëndët ndihmëse të Spiramicine
Ky bar përmban laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj se vuani nga intoleranca ndaj disa sheqernave, flisni me mjekun përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI SPIRAMICINE

Gjithmonë Spiramicine merret ekzaktësisht si ju thotë mjeku juaj. Duhet të konsultoheni me mjekun ose me farmacistin tuaj në qoftë se nuk jeni i sigurt.

Të rriturit: 3 000 000 - 4 500 000 UI në ditë, në 2 – 3 doza të ndara.
Fëmijët me peshë mbi 20 kg: 750 000 UI /10 kg peshë në ditë, në 2 – 3 doza të ndara.
Foshnjet dhe fëmijët e vegjël: 375 000 - 750 000 UI / kg peshë, në 2 – 3 doza të ndara.

Për profilaksinë e meningjitit nga meningokokët:
Të rriturit: 1 500 000 UI, çdo 12 orë;
Fëmijët: 375 000 UI /kg peshë, çdo 12 orë, për 5 ditë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Spiramicine
Në qoftë se keni marrë më shumë Spiramicine se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Spiramicine
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Spiramicine mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Efektet anësore të mundshme të Spiramicine janë çrregullimet gastrointestinale, si: të përziera, të vjella, diarre (këto çrregullime mund të bëhen shkak për ndërprerjen e mjekimit), si edhe reaksionet alergjike në lëkurë.

5. SI TA RUANI SPIRAMICINE

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Spiramicine pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C.
Ruajeni në paketimin origjinal.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Spiramicine.
Lënda aktive është spiramicinë.
Çdo tabletë përmban 750 000 UI spiramicinë.
Lëndët ndihmëse: amidon, laktozë, celulozë mikrokristalore, stearat magnezi, talk dhe glikolat natriumi i amidonit.

Përmbajtja e paketimit:
Kuti me 30 tableta.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.